

**URDHËR**  
**Nr. 221, datë 1.4.2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.165, DATË 12.3.2020 “PËR MBYLLJEN  
E KABINETEVE/KLINIKAVE DENTARE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma “a”, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

**URDHËROJ:**

1. Në pikën 1, të urdhrit nr.165, datë 12.3.2020 “Për mbylljen e kabineteve/klinikave dentare”, togfjalëshi “deri në datën 3.4.2020”, zëvendësohet me togfjalëshin “deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**Ogerta Manastirliu**